



# MANUAL

## PËRDORIMI DHE HAPAT QË NDIQEN NË PORTALIN E APLIKIMIT

Ky manual u vjen në ndihmë maturantëve, mësuesve mbikëqyrës si dhe sekretarive universitare dhe shërben për tu njohur me funksionalitetet, procedurën e aplikimit për programet e studimit në Universitetet Publike dhe Private në Republikën e Shqipërisë.

1

## INFOGRAFIKU I MATURANTIT

Faqe - 3

2

## FAQJA UALBANIA

Faqe - 4

2.1 - Rreth faqes [www.ualbania.al](http://www.ualbania.al)

Faqe - 4

2.2 - Shpjegimi i butonave me ngjyra

Faqe - 5

3

## APLIKACIONI - MATURANTI

Faqe - 6

3.1 - Hyrja e maturantit në portal, hapësira e tij personale

Faqe - 6

3.2 - Shkarkimi dhe konfirmimi i faturës

Faqe - 8

3.3 - Plotësimi i preferencave, konfirmimi dhe printimi

Faqe - 10

4

## APLIKACIONI - Prezantim i maturantit me "Këndin e Maturantit"

Faqe - 12

5

## APLIKACIONI - Prezantim i Mësuesit mbikëqyrës me platformën

Faqe - 14

6

## APLIKACIONI - Prezantim i Sekretarive me platformën

Faqe - 17

7

## Butoni i "Universiteti" dhe "Kriteret"

Faqe - 23 / 25


## 1

## INFOGRAFIKU

### Mënyra e aplikimit të maturantëve.

Shpjegimi i hapave që duhen ndjekur për të aplikuar në platformën U Albania.

Duke filluar nga hapi i parë, i identifikimit me numrin tuaj personal dhe ID-në e maturës, ndiqni me kujdes hapat e tjerë të ilustruara në infografikun e mëposhtëm.



# 2

## FAQJA E U ALBANIA

### 2.1 – Prezantimi me funksionet e faqes.

Shpjegimi i elementëve përbërës dhe informues të faqes U Albania.

Në faqen e ualbania.al ju keni mundësi të shikoni videot orientuese, gjeni të publikuar kalendarin me datat më të rëndësishme të rundeve të aplikimit, gjithashtu gjeni manualin e përdorimit të portalit, *(i cili orienton jo vetëm maturantët, por edhe mësuesit dhe sekretaritë universitare)*.

U Albania

**Portali i Aplikimit Universitar**  
... Këtu fillon e ardhmja...

Aplikimi Rreth U Albania Njoftime FAQ

Aplikimi A2/A3 Këndi Maturantit Universitetet Kriteret Statistika Sekretaria

**LAJMËRIM:** Te dashur maturantë, janë publikuar listat nga universitetet përdorni "Kendin e Studentit" për të kontrolluar preferencat tuaja.

**Si të aplikoni në portal**

Për të aplikuar sa më saktë në portal ndiqni hapat e shpjeguar në videon shpjeguese, grafikon informues, ose lexoni Manualin. Gjithashtu, mund të kontrolloni edhe kalendarin, me datat më të rëndësishme për procesin e pranimit në universitet.

Odhëza Informues Manuali i Përdorimit Kalendari

Video informuese për aplikimin Video informuese për kendin e maturantit

UALBANIA Aplikimi A2 2019 UALBANIA Regjistrimi 2019

Adresë: Rruga e Durrësit Nr.23 Tiranë, Shqipëri ALB-1001 Tel: +355 4 2220198, +355 4 2222200 Email: support@rash.al

RASH





© 2019 - Rrethi Akademik Shqiptar



# FAQJA E U ALBANIA

## 2.2 – Butonat me ngjyra, funksioni i secilit

Shpjegim rreth funksioneve që kryen secili buton në faqe.



Në shiritin e butonave me ngjyra, keni të reshtuar:

- Butoni i **“Aplikim A2/A3”**, ku klikojmë për t’u loguar në portal. *(Këtë buton duhet të klikojnë edhe mësuesit mbikëqyrës, por në ndërfaqen që do u shfaqet duhet të logohen sipas kredencialeve të secilit).*
- Butoni i **“Këndi i maturantit”**, ku maturanti ndjek ecurinë e aplikimit të tij.
- Butoni i **“Universiteti”**, ku maturantët mund të orientohen paraprakisht rreth përzgjedhjes së preferencave duke kontrolluar për çdo universitet, fakultet dhe program studimi kriteret e tyre, mesataret hyrëse, kuotat e pranimit, etj.
- Butoni i **“Kriteret”**, ku maturanti mund të kërkojë të informohet e të ballafaqojë kriteret e preferencave të tij.
- Butoni i **“Statistikat”**, ku mund të shihen statistikat e viteve të mëparshme në portal.
- Butoni i **“Sekretaria”**, ku sekretaritë e universiteteve logohen në portal.


# 3

## APLIKIMI – MATURANTI

### 3.1 – Hyrja në portal dhe hapësira personale e maturantit.


Prezantimi i maturantit me platformën.

Aplikimi do të kryhet nga portali UALBANIA, duke aksesuar në adresën: [www.ualbania.al](http://www.ualbania.al)  
Klikoni mbi butonin “**Aplikimi A2/A3**”.



Në faqen pasardhëse, ju shfaqen 2 butona.

Ju klikoni mbi butonin “**Maturant**”, për të hyrë në hapësirën e maturantit. Më pas, për t’u futur në platformë do shkruani ID-në tuaj të maturës dhe numrin personal të Letërnjoftimit (*ai që fillon dhe mbaron me shkronjë*), për të kryer identifikimin.



Do ju shfaqet hapësira personale si më poshtë:  
Faqja përmban 3 seksione:

- 1) Seksioni i **Informacioneve Personale**
- 2) Seksioni i **Faturës**
- 3) Seksioni i **Aplikimit**

- a) Në seksionin e informacioneve personale, do shikoni të dhënat tuaja.
- b) Në seksionin e faturës, mund të shkarkoni faturën për arkëtim, me të cilën do të kryeni pagesën pranë Postës Shqiptare ose në bankë.

- c) Në seksionin e aplikimit, deri në momentin që nuk është bërë konfirmimi i faturës nga mbikëqyrësi, do ju shfaqet mesazhi ***“Nuk mund të aplikoni sepse nuk keni konfirmuar pagesën!”***.

Pas konfirmimit të faturës, do ju shfaqen fushat për të zgjedhur preferencat.

### Aplikimi


Procedura e aplikimit nuk është hapur ende

## 3.2 - Shkarkimi dhe konfirmimi i faturës

Hapat që ndiqen me shkarkimin dhe konfirmimin e faturës.

Klikoni mbi butonin **“Shkarko”** dhe do ju shfaqet fatura si më poshtë

### Fatura




Shkarko dhe printo një kopje të faturës

- Kop
- Ky n
- Pag





**Bëni kujdes**, fatura përmban një kod 6-shifror unik (*kodi i aplikimit*), i cili gjenerohet për çdo faturë. Ky kod do ju duhet për të konfirmuar pagesën pranë mbikëqyrësit të shkollës, dhe për të përfunduar plotësimin e preferencave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR



**FATURË PËR ARKËTIM**

Nr. Faturës: 20-000015 Datë: DD-MM-VVVV

**Emri i institucionit përfitues:** Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)  
**Kodi i institucionit përfitues:** 1011160  
**Kodi i degës së thesarit ku vepron:** 3535  
**NIPT:** L12207451J  
**Emri Atësia Mbiemri i paguesit:** *Benjan Adnanik Pona*  
**Nr. personal i maturantit:** *8003100015*

	Përshkrimi i të ardhurave	Kodi Ekonomik	Tarifa e shërbimit për Student lekë	Shuma lekë
1.	Pagesë për formularin e Aplikimit Universitar, Matura Shtetërore 2020	7110109	2,000	<b>2,000</b>

Titullari i institucionit Klienti Kodi i aplikimit  
**000015**

*Drejtuar Arkëtarit: Ju lutem vendosni nr. e faturës te përshkrimi i pagesës.*

**Kodi i Aplikimit**

**Pjesa e faturës që duhet ruajtur**

Titullari i institucionit Klienti Kodi i aplikimit  
**000015**

**KUJDES!** Kjo pjesë e faturës duhet ruajtur deri në fund të procesit të hedhjes së preferencave në formularin A2/A3 sepse Kodi i Aplikimit do të përdoret për konfirmimin e preferencave

Pasi të keni kryer pagesën, paraqituni me pjesën e poshtme të faturës (të shënuar më sipër me ngjyrë) dhe me mandatin e pagesës të mbikëqyrësi i shkollës suaj, për të konfirmuar pagesën në sistem.



**KUJDES!** Mund të konfirmoni pagesën vetëm kodin e faturës me të cilën e keni kryer pagesën në bankë!!!!



### 3.3 - Plotësimi i preferencave dhe printimi i tyre.

Plotësimi i preferencave në portal bëhet pasi të jetë konfirmuar pagesa e faturës nga mbikëqyrësi.

Pasi pagesa e faturës suaj të jetë konfirmuar do ju shfaqet mesazhi **“Fatura juaj është konfirmuar”** në seksionin e faturës.

#### Fatura

**Fatura juaj është konfirmuar!**

Lexoni me kujdes rregullat e degëve për mesataren. Tashmë ju mund të plotësoni preferencat tuaja, fillimisht duke zgjedhur Universitetin dhe më pas Programin e studimit. Ju keni mundësi të zgjidhni deri në 10 preferenca. Pasi të keni plotësuar preferencat dhe të jeni të bindur për zgjedhjet që keni kryer, klikoni mbi butonin **“Konfirmo”**


**Aplikimi**

Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjidhni deri në 10 programe studimi</li> <li>• Konfirmoni përzgjedhjet tuaja duke shtypur butonin “Konfirmo”</li> <li>• Vendosni Kodin e aplikimit</li> <li>• Konfirmoni përsëri</li> <li>• Pasi të konfirmohet aplikimi juaj, do t’ju jepet mundësia ta shkarkoni atë</li> </ul>
Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	
Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	
Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	
Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	
Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	
Universiteti	▼	Programi	▼	Pastro	

**Konfirmo**

Do ju shfaqet modali i konfirmimit, ku duhet të vendosni kodin e aplikimit që gjendet te kopja juaj e faturës, me të cilën keni kryer pagesën.

**Vendosni Kodin e aplikimit** në fushën përkatëse, dhe **klikoni** butonin **KONFIRMO**



Në këtë moment, aplikimi juaj është konfirmuar dhe do t'ju shfaqet butoni **“Shkarko”** për shkarkimin e aplikimit.


**Aplikimi**

**Aplikimi është konfirmuar!**

Universiteti	Programi i studimit
UNIVERSITETI I TIRANËS	Biologji
UNIVERSITETI I TIRANËS	Financë
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Teknikë Dentare
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS	Administrim Publik
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gazetari
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë - Letërsi

**Shkarko**

Printoni formularin e aplikimit




## 4

## KËNDI I MATURANTIT

### Prezantimi me “Këndi i Maturantit”.

Logimi në portal i maturantit dhe tabela e renditjes.



Pasi të ketë kryer procedurën e aplikimit, maturanti ka mundësi të ndjekë procesin e renditjes në degët ku ai ka aplikuar.

Mjafton të klikoj mbi butonin “Këndi i Maturantit” e në ndërfaqen që do shfaqet, të shkruajë ID-në e tij të maturës. Te kjo ndërfaqe do u pasqyrohen në formën tabelare dhe në kohë reale renditja e programeve studimore të përzgjedhura prej tij.

Vendosni ID-në e maturës




NR	Universiteti	Programi i studimit	Pikë	Rendi në klasifikim	Kuota në këtë fazë	Kuota në fazën e ardhshme	Klasifikimi në fazën e ardhshme
----	--------------	---------------------	------	---------------------	--------------------	---------------------------	---------------------------------

SQARIMI! Ju bëjmë me dijeni, se në këndin e maturantit nuk do të ketë vlera në kolonën "KLASIFIKIMI NË FAZËN E ARDHSHME" për preferencat me ngjyrë jeshile (fitues ose të regjistruar), sepse për këto preferenca nuk do të ketë fazë të ardhshme.

#### LEGJENDA E NGJYRAVE

Për një nga arsyet e mëposhtme:

- Ju jeni fitues në atë program studimi,
- Ju jeni regjistruar në atë program studimi.

Nuk keni fituar në këtë program studimi, për një nga arsyet e mëposhtme:

- Ju nuk i keni arritur pikët minimale për të qënë fitues në atë program studimi,

Ju jeni përjashtuar nga rankimi i kësaj liste, për një nga arsyet e mëposhtme:

- Ju jeni fitues në këtë program studimi por duhet të prisni për azhurnimin e listës.

Në fazën e fundit, ngjyra e verdhë zëvendësohet me ngjyrën jeshile dhe fituesit duhet të regjistrohen brenda 48 orëve

Për një nga arsyet e mëposhtme:

- Ju jeni regjistruar në një program tjetër studimi,
- Ju keni qënë fitues në këtë program, por nuk jeni regjistruar në fazën përkatëse
- Janë zënë të gjitha kuotat e përcaktuara për këtë program studimi



Pasi të jeni loguar, do ju shfaqet tabela me preferencat tuaja. Poshtë tabelës ndodhet një sqarim dhe më poshtë ndodhet legjenda e ngjyrave që ju informon rreth domethënies së çdo ngjyre të përdorur te preferencat e renditura.

ID Maturanti  
 200100200196
 🔍 Kërko
✖️ Pastro

NR	Universiteti	Programi i studimit	Pikë	Rendi në klasifikim	Kuota në këtë fazë	Kuota në fazën e ardhshme	Klasifikimi në fazën e ardhshme
1	UNIVERSITETI I TIRANËS	Bioteknologji	979				
2	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	995				
3	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	145502				
4	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	145502	48	68	57	
5	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	145502	63	22	13	32
6	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	13692	4	59	28	
7	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturë profili Arkitekt	13689				
8	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Ndërtimi	13689				
9	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Fizioterapi	145502	21	19	19	18
10	UNIVERSITETI ALDENT	Stomatologji	9879	12	52	49	

**SQARIM!** Ju bëjmë me dije, se në këndin e maturantit nuk do të ketë vlera në kolonën "KLASIFIKIMI NË FAZËN E ARDHSHME" për preferencat me ngjyrë jeshile (fitues ose të regjistruar), sepse për këto preferenca nuk do të ketë fazë të ardhshme.

**LEGJENDA E NGJYRAVE**

Për një nga arsyet e mëposhtme:

a) Ju jeni fitues në atë program studimi,  
b) Ju jeni regjistruar në atë program studimi.

Nuk keni fituar në këtë program studimi, për një nga arsyet e mëposhtme:

a) Ju nuk i keni arritur pikët minimale për të qënë fitues në atë program studimi,

Ju jeni përjashtuar nga rankimi i kësaj liste, për një nga arsyet e mëposhtme:

a) Jeni fitues në këtë program studimi por duhet të prisni për azhormimin e listës.

Në fazën e fundit, ngjyra e verdhë zëvendësohet me ngjyrën jeshile dhe fituesit duhet të regjistrohen brenda 48 orëve

Për një nga arsyet e mëposhtme:

a) Ju jeni regjistruar në një program tjetër studimi,  
b) Ju keni qënë fitues në këtë program, por nuk jeni regjistruar në fazën përkatëse  
c) Janë zënë të gjitha kuotat e përcaktuara për këtë program studimi

Regjistrimi i preferencës fituese bëhet në sekretarinë e fakultetit.


## 5

## MËSUESI MBIKËQYRËS


Logimi në portal i Mbikëqyrësit.

Logimi në portal i Mësuesit mbikëqyrës dhe konfirmimi i faturave të maturantëve.

Mësuesi mbikëqyrës për t'u loguar në portal duhet të klikojë mbi butonin **“Aplikimi A2/A3”**



Në faqen pasardhëse, shfaqen 2 butona. Duhet të klikoni mbi butonin **“Mbikëqyrës”**.



Më pas, do të përdorni adresën tuaj të email-it dhe fjalëkalimin i cili ju është dërguar me email për të kryer identifikimin.

Në rast se keni humbur fjalëkalimin, kontaktoni me suportin teknik në adresën support@rash.al

The image shows a login form for the U Albania portal. The form has a header with the U Albania logo and the text "MIRË SE VINI NË PORTALIN E APLIKIMIT UNIVERSITAR". Below the header are two input fields: "Email" and "Fjalëkalimi". A blue button labeled "Identifikohuni" is positioned below the "Fjalëkalimi" field. A link labeled "Kthehu" is located at the bottom of the form. Two yellow callout boxes are present: one on the left pointing to the "Email" field with the text "Vendosni Adresën tuaj të email-it", and one on the right pointing to the "Fjalëkalimi" field with the text "Vendosni Fjalëkalimin që ju është dërguar tek email-i juaj."

Pasi të jeni loguar, do ju shfaqet hapësira personale si më poshtë.

Ndërsa në tabelë shfaqet lista e maturanëve të shkollës suaj të cilët kanë plotësuar formularin A1.

The screenshot shows the user interface of the U Albania portal. At the top, there is a navigation bar with the user's name "John Doe" and email "johndoe@gmail.com". Below the navigation bar is a search bar for "Kërko maturanin" with fields for "Emri", "Mbiemri", "ID e Maturës", and "Numri personal". A "Kërko" button and a "Pastro" button are also present. Below the search bar is a table titled "Lista maturanëve" with the following columns: "Emër", "Mbiemër", "ID e Maturës", "Numri Personal", and "Konfirmo". The table contains 13 rows of student data.

Emër	Mbiemër	ID e Maturës	Numri Personal	Konfirmo
Endona	Mica	19374300001	K1540202L	<a href="#">Konfirmo</a>
Lulë	Bredha	19374300002	K1552802P	<a href="#">Konfirmo</a>
Florida	Oeta	19374300003	K1560202G	<a href="#">Konfirmo</a>
Rozalinda	Nedë	19374300004	K1581402C	<a href="#">Konfirmo</a>
Eminald	Muma	19374300005	K0993002C	<a href="#">Konfirmo</a>
Elinda	Khafe	19374300006	K1609002N	<a href="#">Konfirmo</a>
Edson	Jefeko	19374300007	K0922042D	<a href="#">Konfirmo</a>
Belem	Geurfi	19374300008	K1091602D	<a href="#">Konfirmo</a>
Jefnor	Shurfi	19374300009	K1048002P	<a href="#">Konfirmo</a>
Ilgen	Geurfi	19374300010	K1079002L	<a href="#">Konfirmo</a>
Ageta	Gredica	19374300011	K1511402B	<a href="#">Konfirmo</a>
Lulenda	Cahari	19374300012	K06121004W	<a href="#">Konfirmo</a>
Milind	Tula	19374300013	K1009002B	<a href="#">Konfirmo</a>

Për të gjetur maturanët, mund të përdorni fushën e kërkimit

Q Kërko maturanin

Emri \_\_\_\_\_ Mbiemri \_\_\_\_\_ ID e Maturës \_\_\_\_\_ Numri personal \_\_\_\_\_

Q Kërko X Pastro

Pasi maturanti të jetë paraqitur me mandatin e pagesës dhe gjysmën e faturës së sistemit, e cila përmban kodin e aplikimit, **konfirmoni pagesën**.

Konfirmo

Konfirmo

Konfirmo

Në dritaren që do ju shfaqet, **vendosni kodin e aplikimit** që gjendet tek kopja e faturës së maturanit.

Lista maturanëve

Emër	Mbiemër	Konfirmo		
Endona	Mica	Konfirmo		
Lufë	Brasha	Konfirmo		
Flonda	Çafa	Konfirmo		
Rozalinda	Yezig	Konfirmo		
Emenad	Morina	Konfirmo		
Erlinda	Khafe	Konfirmo		
Edson	Jahelid	193724700007	K009220400	Konfirmo
Bekim	Çauqi	193724700008	810810040	Konfirmo

Jeni të sigurt që dëshironi ta konfirmoni këtë pagesë?

Kodi i aplikimit \*  
050|

Anullo Konfirmo

Pasi të konfirmoni pagesën, maturanti ka mundësinë të plotësojë preferencat në datat e caktuara.




# 6

## SEKRETARIA

### Logimi në portal i Sekretarisë

Për Dekanin, Administratorin e Universitetit dhe Sekretaret.

Sekretaria për t'u loguar në portal duhet të klikojë mbi butonin **"Sekretaria"**.



Më pas, do përdorni adresën tuaj të email-it dhe fjalëkalimin i cili ju është dërguar me email për të kryer identifikimin.

Në rast se keni humbur fjalëkalimin, kontaktoni me administratorin e universitetit.




Sipas kredencialeve që përdorni për të hyrë në sistem, do ju shfaqet ndërfaqja e rolit që ju keni në universitet. Pra, me këtë login, mund të futen: Dekani, Administratori i universitetit dhe Sekretaret.

# 1

Kur logoheni si **Administrator i universitetit**, ju shfaqet ndërfaqja me këto funksione:

## Aplikimet

Zgjidhet *Fakulteti* dhe *Programi i studimit* dhe më pas shtypet butoni “Gjenero”. Pasi të jetë gjeneruar shkarkoni listën e aplikantëve për atë degë të fakultetit.



## Renditja

Fillimisht shkarkohet modeli i Excel-it duke klikuar mbi butonin “Shkarko modelin”. Më pas zgjidhet *Fakulteti* dhe *Programi i studimit* dhe më pas shtypet butoni “Choose File” (zgjidh dokumentin). Kur të keni zgjedhur dokumentin, shtypni butonin “Ngarko”.

Në tabelën “Listat e ngarkuara” do shfaqet Fakulteti, Programi i studimit dhe do të keni mundësinë për ta Konfirmuar ose për ta fshirë listën nëse mendoni që nuk është

lista e saktë. Pasi të keni klikuar mbi tekstin **“Konfirmo”**, lista quhet e konfirmuar dhe nuk keni më mundësi ta fshini.

**Ngarkimi i listave**

**Kujdes!**

- Shkarkoni modelin e formatit të Excel-it duke klikuar mbi butonin "Shkarko Modelin".
- Zgjidhni fakultetin, më pas Programin e studimit dhe klikoni mbi butonin "Ngarko Listën".
- Pasi të jetë ngarkuar lista, në tabelën e mëposhtme keni mundësinë e konfirmimit të butonit "Konfirmo".

Shkarko template

Fakulteti:  Programi:   No file chosen

**Listat e ngarkuara**

Fakulteti	Programi	Konfirmo	Fshi
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	Sjuhë - Letërsi	Konfirmuar	
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	Histori	Konfirmuar	

**Staf fakulteti** Këtu, administratori i universitetit, mund të shtojë sekretare të fakultetit që do merren me regjistrimet.

**Kërko (Sekretar/Dekan)**

Emri:  Mbiemri:  Email:  Fakulteti:

**Lista Sekretar/Dekan**

Emër	Mbiemër	Email	Fakulteti	Grupi	Veprime
id	id	id.ualbania.al	Fakulteti i Ekonomisë	Faculty Secretary	<input type="button" value="edit"/> <input type="button" value="delete"/>
id	id	id.ualbania.al	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Faculty Secretary	<input type="button" value="edit"/> <input type="button" value="delete"/>

## Raporte

Administratori i universitetit mund të shikojë të dhëna mbi regjistrimet në faza të ndryshme si dhe çregjistrimet që janë kryer.


Raundi:  Fakulteti:


**Të dhëna mbi regjistrimet**

Dega	FAZA 1	FAZA 2	FAZA 3	CREGJISTRIM
		Të regjistruar	Abandonues	Të regjistruar diku tjetër
Biologji	0	77	28	-
Bioteknologji	0	52	67	-


# 2

Kur logoheni si **Sekretar**, ju shfaqet ndërfaqja me këto funksione:


**Regjistrime** Regjistrimet e aplikantëve bëhen në tabelë, te butoni . Pasi të jetë regjistruar, mund të printohet deklarata.



**Statistika** Paraqitet tabela me të gjithë të regjistruarit si dhe keni mundësi t'i shkarkoni në format exceli.



**Raporte** Të dhëna mbi regjistrimet në faza të ndryshme.





## Regjistrimet e përfunduara

Tabela e të gjithë aplikantëve të regjistruar. Këtu mund të bëhet edhe kërkesa për çregjistrim e cila aprovohet nga Dekani.

FAZA 2 UNIVERSITETI I TIRANËS

Q Kërko

Emri Mbiemri Email ID Maturanti Programi Administrim - Biznes

Q Kërko X Pastro

Lista e regjistrimeve

Renditja	Emër	Mbiemër	ID Maturanti	Numri personal	Programi	Veprime
1	Arta	Mehmeti	201904000004	K23900002V	Administrim - Biznes	Çregjistro

## Kërkesa për çregjistrim

Në këtë tabelë shfaqen të gjithë ata aplikantë që kanë kërkuar të çregjistrohen.

FAZA 2 UNIVERSITETI I TIRANËS

Q Kërko

Emri Mbiemri ID Maturanti Raundi Raund 1 Faza FAZA 2 Programi Administrim - Biznes

Q Kërko X Pastro

Shkarko në Excel

Lista e kërkesave për çregjistrime

Emër	Mbiemër	ID Maturanti	Numri personal	Programi	Data çregjistrimit	Veprime
Arta	Mehmeti	201904000004	K23900002V	Administrim - Biznes		
Nesir	Selimani	201907000131	K136000008	Administrim - Biznes		

## Çregjistrimet

Në këtë tabelë shfaqen të gjithë aplikantët që janë çregjistruar.

FAZA 2 UNIVERSITETI I TIRANËS

Q Kërko

Emri Mbiemri ID Maturanti Raundi Raund 1 Faza FAZA 2 Programi Administrim - Biznes

Q Kërko X Pastro

Shkarko në Excel

Lista e çregjistrimeve

Emër	Mbiemër	ID Maturanti	Numri personal	Programi	Data çregjistrimit	Veprime
Arta	Mehmeti	201904000004	K23900002V	Administrim - Biznes		

Items per page: 100 1-1 of 1 < >

## 3

Kur logoheni si **Dekan** i fakultetit, ju shfaqet ndërfaqja me këto funksione: **Kërkesa për çregjistrimet** dhe **Çregjistrimet**.

Te zëri “**Kërkesa për çregjistrimet**”, mund të kryhet çregjistrimi. Kurse në zërin tjetër “**Çregjistrimet**” do shikoni listën e aplikantëve që janë çregjistruar.

The screenshot displays the 'U Albania' portal interface. The top navigation bar includes 'FAZA 2' and 'UNIVERSITETI I TIRANËS'. The left sidebar shows 'Kërkesa për çregjistrimet' and 'Çregjistrimet'. The main content area features a search bar with filters for 'Emri', 'Mbiemri', 'ID Maturanti', 'Raundi' (Raund 1), 'Faza' (FAZA 2), and 'Programi' (Administrim, Biznes). Below the search bar is a 'Shkarko në Excel' button and a section titled 'Lista e kërkesave për çregjistrime'. This section contains a table with the following columns: Emër, Mbiemër, ID Maturanti, Numri personal, Programi, Data çregjistrimit, and Veprime. The 'Veprime' column for the first row contains a button labeled 'Çregjistro', which is circled in red. The table footer indicates 'Items per page: 100' and '1 - 1 of 1'.


Emër	Mbiemër	ID Maturanti	Numri personal	Programi	Data çregjistrimit	Veprime
Senanq	Senanq	2019274601151	4138000008	Administrim, Biznes	Senanq	Çregjistro

## 7


## BUTONI “UNIVERSITETI”

7.1 – Hapësira informuese rreth universiteteve publike e private dhe programeve të tyre të studimit. Maturanti shikon kriteret e programeve për universitetet.

Duke klikuar mbi butonin “Universitetet”, do kalojmë te faqja ku paraqiten logot e universiteteve publike dhe private.



Maturanti do klikojë mbi logon e universitetit që ka synim të studiojë.



Pasi të klikohet logo e universitetit do shfaqet faqja me disa tabela informuese rreth:


- **“Fakultetet”**. Në këtë tabelë mund të zgjidhni atë fakultet që jeni të interesuar për të ndjekur studimet.
- **“Programet e Studimit”**. Në këtë tabelë shfaqen programet e studimit të fakultetit që ju keni përzgjedhur në tabelën përbri.
- Në tabelën e madhe, poshtë, renditen tabela të vogla me informacione rreth:
  1. **“Kriteret mbi Mesataren”**, ku jepet sqarim rreth *Tipit të kriterit, Peshës dhe Shënime*.
  2. **“Kriteret mbi Lëndët”**, ku jepet sqarim rreth *Lëndës Kriter, Peshës, Ndikimit dhe Shënime*.
  3. **“Shënime të tjera rreth kriterëve”**
  4. **“Mesatarja hyrëse”**
  5. **“Kuotat”** – Renditen kuotat e shpallura.
 Dhe detaje të tjera për të informuar maturantin.

The screenshot displays the 'U Albania' portal interface. At the top, it shows the university's name and logo. Below this, there are two main navigation tabs: 'Fakultetet' (Faculties) and 'Programet e Studimit' (Study Programs). Under 'Fakultetet', three options are listed: 'Fakulteti i Mjekësisë', 'Fakulteti i Mjekësisë Dentare', and 'Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike'. Under 'Programet e Studimit', two options are listed: 'Mjekësi e Përgjithshme' and 'Farmaci'. The 'Program Studimi' section is expanded, showing detailed information for the 'Mjekësi e Përgjithshme' program. It includes sections for 'KRITERET' (Criteria), 'MESATARJA HYRËSE' (Entrance Average), and 'KUOTAT' (Quotas). The 'KRITERET' section is divided into three parts: '1. Mbi mesataren' (About the average), '2. Mbi lëndë' (About subjects), and '3. Të tjera' (Others). The 'MESATARJA HYRËSE' section shows the academic year (2020-2021) and the average score (8.50). The 'KUOTAT' section shows the number of places (260). The '1. Mbi mesataren' section includes a table with columns for 'Tipi kriterit' (Type of criterion), 'Pesha' (Weight), and 'Shënime' (Notes). The '2. Mbi lëndë' section includes a table with columns for 'Lënda Kriter' (Subject criterion), 'Pesha' (Weight), 'Ndikon' (Affects), and 'Shënime' (Notes). The '3. Të tjera' section includes a section for 'Shënime' (Notes) with a paragraph of text and a link to 'Me shume'.

## BUTONI “KRITERET”

### 7.2 – Hapësira ku maturanti mund të bëjë krahasimet e kritereve të programeve të studimit për çdo universitet.

Çdo maturant, përpara se të plotësojë përzgjedhjet e tij, mund të ballafaqojë kriteret e degëve.



Ballafaqimi i kritereve bëhet duke klikuar butonin “**Kriteret**” dhe në faqen pasardhëse mund të zgjedhë “*Universiteti*” dhe “*Programi i studimit*” dhe më pas të klikojë butonin “+” dhe poshtë do shfaqet tabela me të gjitha kriteret.

Më pas maturanti mund të kërkojë një universitet tjetër apo një tjetër program studimi dhe të klikojë përsëri butonin “+”. Poshtë, veç tabelës së kërkimit të parë, shfaqet edhe tabela me të dhënat e kritereve të kërkimit të dytë.

Kështu maturanti ka mundësi të ballafaqojë kriteret e programeve të studimit ku ai mendon të aplikojë.

U Albania
KRITERET E UNIVERSITETEVE

Zgjidhni Universitetin

UNIVERSITETI I TIRANËS

Zgjidhni Programin e Studimit

Bioteknologji

Universiteti I Mjekësisë I Tiranës / Farmaci
✕

MESATARJE HYRËSE

Për vitin akademik: 2020 - 2021 Mesatare VKM: 8.50

1. Kriteret mbi mesataren

Tipi kriterit	Pesha	Shënime
Mesatare e matures shtetore	40%	Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje: Kimi, Fizikë, Biologji, nota e provimit shumëzohet me 1.4. Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje... <a href="#">Më shumë</a>
Mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30%	Pesha në përqindje e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme (për të gjitha vitet) është 30%.

2. Kriteret mbi lëndë

Lënda Kriter	Pesha	Ndikon	Shënime
Kimi	10%	Jo	Nota mesatare aritmetike e lëndëve formuese (Fizikë, Kimi dhe Biologji), të zhvilluara gjatë tri viteve të shkollës së mesme 30%ku (lëndët Fizikë, Ki... <a href="#">Më shumë</a>
Fizikë	10%	Jo	Nota mesatare aritmetike e lëndëve formuese (Fizikë, Kimi dhe Biologji), të zhvilluara gjatë tri viteve të shkollës së mesme 30%ku (lëndët Fizikë, Ki... <a href="#">Më shumë</a>
Biologji	10%	Jo	Nota mesatare aritmetike e lëndëve formuese (Fizikë, Kimi dhe Biologji), të zhvilluara gjatë tri viteve të shkollës së mesme 30%ku (lëndët Fizikë, Ki... <a href="#">Më shumë</a>

3. Kriteret të tjera

Shënime

Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme për të gjitha vitet të jetë > ose = 8.5. Kjo notë përllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm dhe mesatarja... [Më shumë](#)

Universiteti I Tiranës / Bioteknologji
✕

MESATARJE HYRËSE

Për vitin akademik: 2020 - 2021 Mesatare VKM: 6.50

1. Kriteret mbi mesataren

Tipi kriterit	Pesha	Shënime
Mesatare VKM	70%	Mesatarja sipas VKM

2. Kriteret mbi lëndë

Lënda Kriter	Pesha	Ndikon	Shënime
Biologji	20%	Jo	Nota e Biologjisë 12, nga kurrikula me zgjedhje e vitit III
Kimi	10%	Jo	Nota e Kimisë 12, nga kurrikula me zgjedhje e vitit III

Adresa: Rruga e Durrësit Nr.23 Tiranë, Shqipëri ALB-1001

Tel: +355 4 2230198, +355 4 2222260

Email: support@rash.al

© 2020 - Rrjeti Akademik Shqiptar

Maturanti ka mundësi të ballafaqojë kriteret e Universiteteve private ose publike për programet ku është i interesuar.

Gjithashtu ai, mund të informohet rreth kurrikulës apo stafit akademik.







Rrjeti Akademik Shqiptar  
Rruga e Durrësi Nr. 219. 1001, Tiranë  
info@rash.al  
www.rash.al



**U ALBANIA**  
Portali i Aplikimit Universitar  
support@rash.al  
www.ualbania.al